



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality of Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturę, Omladinu i Sport
Department of Culture, Youth and Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA




KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Odeljenje za Kulturę, Omladinu i Sport

-XIII- Nr. i prot. 86 Më Dt. 02.04.2026
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORTI JANAR - MARS 2026

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Rahovec, prill 2026

Drejtoria për kulturë, rini dhe sport

Letërnjoftimi i shkurtër lidhur me Kulturën, Rinin dhe Sportin në Rahovec.

Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Kosovës. Është ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte antike të trashëguara nga epokat e hershme ilire-romake, objekte të trashëgimisë arkitekturore, shpirtërore, fetare, etnologjike etj. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/ arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm arkeologjik, shpella, trashëgimi arkitekturore dhe fetare. Në komunën e Rahovecit zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore, rinore e sportive, aktivitete muzikore, teatrale, bibliotekare, ekspozita, festivale e aktivitete të ndryshme kulturore. Aktivitete të ndryshme zhvillohen në qendrat kulturore në Rahovec, Krushë të Madhe, Hoçë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc e gjetkë. Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi", me degët në Krushë të Madhe, Ratkoc e Hoçë të Madhe, qendrat sportive në Rahovec, palestra "Mizahir Isma", terrenet e sportit në Krushë të Madhe, Xerxë, Ratkoc, Dejnë dhe në disa lagje të qytetit, ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e sportit e rekreacionit. Po ashtu, funksionojnë shoqëritë kulturore-artistike, grupet muzikore e artistike, shoqatat e ndryshme, një qendër rinore aktive, që zhvillojnë aktivitete në këto objekte kulturore, rinore e sportive. Ndër aktivitetet kryesore kulturore e promovuese që organizohen në komunën e Rahovecit janë; festivali i folklorit "Anadrinia Jehon" festa e Vjeljes së rrushit "Hardh Fest", "Agrofest", Festivali Ndërkombëtar i Poezisë, si dhe aktivitete të ndryshme periodike kulturore, rinore, sportive e promovuese.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e përbërë prej tre sektorëve: Kulturë, Rini dhe Sport, me një buxhet të caktuar, i mbulon tre fusha të rëndësishme në jetën e përditshme.

Aktivitetet që i përfshin drejtoria janë: aktivitetet rinore, sportive, ruajtja e trashëgimisë kulturore, shfaqjet teatrale, muzikë, art.

- Në raport të punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekte, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.
- Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe, është angazhuar që të gjitha projekte e aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim

të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.

- Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara përgjatë kësaj periudhe.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport poashtu trajton kërkesat e palëve për shfrytëzimin e këtyre objekteve kulturore e sportive:

- Shtëpia e Kulturës në: Rahovec, Ratkoc, Xërxë, Krushë të Madhe dhe Drenoc.
- Bibliotekën “Sulejman Krasniqi” në Rahovec, Krushë të Madhe, Ratkoc dhe Hoçë të Madhe.
- Kompleksin sportiv në Rahovec dhe fushat tjera sportive.
- Palestrën sportive “Mizahir Isma”.

Përveq buxhetit të caktuar komunal, drejtorja ka bërë përpjekje për të gjetur edhe burime të tjera financiare përmes bashkëpunimit me OJQ, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, strukturat e pushtetit lokal, donatorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe pushtetin qendror MKRS-në.

Çfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmbledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në mars të vitit 2026. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së.

AKTIVITETE E MUAJIT JANAR

Gjatë këtij muaji Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- Vizita në objektet që janë në kuadër të drejtorisë.
- Formimi i keshillit organizues për aktivitetin përkujtimor “Flaka e Janarit”.
- Takim njoftues me klubet sportive si dhe shoqëritë kulturore – artistike që veprojnë në Komunën e Rahovecit.
- Takim njoftues me të gjithë operatorët e projekteve që operojnë në DKRS.

- Homazhe përkujtimore për nder të "Flaka e Janarit" në Celinë, Krushë të Madhe, Nagavc dhe Hoqë të Vogël dhe tek vendi i rënjes në Brestoc. Manifestimi përkujtimor është përmbyllur me ceremoninë përkujtimore në Qendrën Kulturore "Mensur Zyberaj",.
- DKRS në bashkëpunim me shoqatën e pedagogëve të kulturës fizike ka mbajtur garën shkollore në futboll të vogël, basketboll dhe volejball.
- Shoqata e pedagogëve të kulturës fizike të Komunës së Rahovecit në bashkëpunim me Drejtorinë për kulturë, rini dhe sport, organizuan garat komunale në futboll të vogël, basketboll dhe volejball me nxënësit e shkollave fillore të komunës sonë.
- Pjesëmarrje në Akademinë Përkujtimore për Prof. Dr Sabahajdin Cena, në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, për nder të 3 vjetorit të vdekjes së tij,
- Vendim për ndalimin e pirjes së duhanit në palestren sportive dhe objektet e hapura dhe të mbyllura sportive publike në Komunën e Rahovecit
- Për nder të manifestimit tradicional, kulturor e përkujtimor "Flaka e Janarit", Komuna e Rahovecit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall konkurs për art letrar, pamor dhe film dokumentar me metrazh të shkurtër.
- Manifestimi Flaka e Janarit, ku janë bërë homazhe te vendi i të rënëve si dhe manifestimin kulturor artistik, ku janë përzgjedhur fituesit e konkursit të artit letrar dhe është mbajtur pikë artistike nga Shkolla e Muzikës "Faik Sylka" dhe SH.K.A Bajram Curri.

AKTIVITETET E MUAJIT SHKURT

- Gjatë këtij muaji Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:
- Për nder të 17 Shkurtit Ditës së Pavarësisë së Kosovës është formuar këshilli organizues lidhur me zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të kësaj dite
- Në qendrën e kulturës "Mensur Zyberaj", është bërë promovimi i librit i një autoreje antare e OJQ "FARDI".
- Me datë 05.03.2025 është publikuar thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve, klubeve sportive, shoqërive kulturo-artistike etj., të komunës sonë.
- Me datë 12.02.2025 kanë filluar aktivitetet sportiv në Volejball, sipas agjendës së këshillit organizues për nder të 17 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

- Kanë përfunduar me sukses të gjitha aktivitetet e parapara për nder të 17 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.
- Janë mbajtur homazhe në nderim të heronjëve dhe dëshmorëve të kombit tek varrezat e dëshmorëve në Rahovec.
- Është organizuar aktivitete kulturore, përkujtimore e sportive në këtë organizim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
- Aktivitetet përkujtimore, kulturore e sportive në kuadër të shënimit të 17-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës u permbyllën me koncertin e shkollës së muzikës “Faik Sylka” nga nxënësit e kësaj shkolle.
- Nënshkrimi i kontratës me SBASHK për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, përkatësisht në shtëpinë e kulturës.
- Pëlqim për lejimin e shfrytëzimit të kompleksit sportive për aktivitetet sportive për KF Xërxa, KF Drenoci, SHF Grape City. Poashtu pelqim kanë edhe KF Rahoveci, KFV Rahoveci, dhe SHF Clinnic Soccer.

Janë mbajtur takim me të rinjët e Komunës së Rahovecit në Qendrën Rinore “SHL-Kosova”, në takim është diskutuar për qështje të ndryshme, si aktivitetet e përbashkëta, trajnimet, debatet e aktivitetet të lira për të rinjët e Rahovecit.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport ka si mision fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje të të rinjve në jetën aktive shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore, duke respektuar veçoritë individuale tek të rinjtë.

Pjesëmarrja në punëtorinë e organizuar nga GAIA, GIZ dhe ITP lidhur me projektet dhe grantet nga organizatat e huaja lidhur me rininë.

AKTIVITETE NË MUAJIN MARS

Gjatë këtij muaji Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitete të ndryshme dhe patë angazhime të ndryshme:

- Takim me Kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, është kërkuar mbështetje në rregullimin dhe standardizimin e disa fushave të futbollit sipas standardeve të UEFA. Janër dërguar dokumentacionit shtesë në Federatën e Futbollit të Kosovës, lidhur me kërkesën për rregullimin e fushave të Futbollit në Ratkoc, në Krushe të Madhe dhe në Rahovec.
- Në bashkëpunim me OVL-UÇK-në janë mbajtur aktivitetet e 5, 6 dhe 7 Marsit – Epopeja e UÇK-së.
- Kemi mbajtur takim me përfaqësuesit e OVL-UÇK-së, për organizimin e aktiviteteve përkujtimore që fillojnë nga data 25 mars, ku dhe është bërë agjenda për homazhe nga data 25 Mars – 02 Prill 2025.
- Vizita në të gjitha vendpunimet ku janë duke u kryer punët të cilat janë në kuadër të DKRS-së.
- Është dorëzuar në mënyrë elektronike aplikimi për grant në organizatën SALTO në fushën e rinisë.
- Në bibliotekën komunale “Sylejman Krasniqi” është mbajtur aktivitet për ditën botrore të Poezisë, aktiviteti u mbajt në bashkëpunim me klubin letrar “Xhevdet Bajraj”.
- Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit u bëri thirrje të gjithve, Klubeve, Shoqatave sportive të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar e fushat sportive, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që do të kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e sportit dhe organizimin rinor gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Rini dhe Sport, në Komunën e Rahovecit. Me datë 05.03.2025 është publikuar thirrja publike për subvencionimin e OJQ-ve, klubeve sportive, shoqërive kulturo-artistike etj., të komunës sonë. Kanë aplikuar gjithsej 40 OJQ, prej tyre 13 nga sektori I kulturës dhe 27 nga sektori I rinisë dhe sportit.
- Takim, me grupin punues rreth hartimit të planit për Trashegimi Kulturore.
- Aktivitet në bibliotekën komunale “Sylejman Krasniqi” me klubin letrar “Xhevdet Bajraj”.
- Shfaqje teatrale në Shtëpinë e Kulturës “Mensur Zyberaj”, në bashkëpunim me Edronia Art prokusion nga Shkupi, shfaqja është mbajtur me disa nga shkollat fillore të Rahovecit.
- Aktivitet në qendrën e kulturës “Mensur Zyberaj”, aktiviteti i realizuar nga nxënësit eshkollës profesionale “Selajdin Mullabazi”, 27.03.2026.

- Tubim përkujtimor në fshatin Ofterush, një pjesë e stafit e angazhuar me zërim.
- Produksioni Edronia Art, nga Shkupi, ka mbajtur shfaqje me nxënëse të shkollës fillore në shtëpinë e kulturës në fshatin Xërxe.
- Tubim përkujtimor më 02.04.2026 në fshatin Hoqë e Vogël, një pjesë e stafit ka qenë e angazhuar me zërim.
- Gjatë kësaj periudhe është bërë dhe përmbyllja e raportit të performancës së drejtorisë për vitin 2025.
- Fillimi i punimeve në fushën sportive në Polluzhë.
- Zbulimi i pllakës përkujtimore në trojet e Sali Bajraktarit
- Takim dy ditor me delegacionin nga Bashkia e Mirditës dhe Mallakastrës. Në koordinim me kryesuesin e Kuvendit në Rahovec, është organizuar vizitë në disa monumente historike dhe kulturore në komunën tone.

BIBLOTEKA KOMUNALE “SULEJMAN KRASNIQI” - RAHOVEC

Gjatë kësaj periudhe, kemi bashkëpunuar me dashamirës të librit: mësime, nxënës, shkrimtarë të komunës sonë, në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijes rreth lexueshmërisë. Biblioteka në tërësi ka ruajtur vazhdimësinë e punës së saj profesionale në shërbim të lexuesve, të atyre përdoruesve që kanë pasur nevojë për shërbime të ndryshme, si në kërkim të librit, në shfrytëzim të sallës dhe shërbimeve të tjera.

Anëtarësia dhe libra të lexuara

Janar-Mars	Anëtar të regjistruar	Të rinjë		Të rritur		Me pagesë	Falas	Lib.të lexuara
		Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra			
Rahovec	122	51	63	3	5	122	Rahovec	122
Krushë	3	0	2	0	1	3	Krushë	3
Ratkoc	1	1	0	0	0	1	Ratkoc	1
Gjithsej	126	52	65	3	6	126	Gjithsej	126

Përbërja sociale e lexuesve

Jan-Mars	Nxënës	Studentë	Punëtor	Bujq	Amvise	Të tjerë	Gjithsej
Rahovec	114	2	3	0	1	2	122
Krushë e Madhe	2	0	0	0	1	0	3
Ratkoc	1	0	0	0	0	0	1
Gjithsej	117	2	3	0	2	2	126

Salla e leximit - Pasurimi i fondit librar - Fondi librar në biblioteka

Janar - Mars	Salla e leximit	Pasurimi i fondit librar	Fondi librar në biblioteka
Rahovec	15	63	22817
Krushë e Madhe	14	12	4570
Ratkoc	0	12	1852
Gjithsej	29	87	29239

Aktivite Janar

Me datë: 14.01.2026 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec e falënderon shumë OVL-Organizata e Veteranëve të luftes së UÇK-së Komuna Rahovec për dhurimin e librave të autorit Prof.dr. Sabahajdin Cena të cilët e pasuruan bibliotekën tonë me titullin:

Proza popullore legjendare shqiptare 10 ekzemplarë.

Kronikë nëpër stuhi I 6 ekzemplarë.

Kronik nëpër stuhi III 11 ekzemplarë.

Kronikë nëpër stuhi IV 11 ekzemplarë.

Në Krushë të madhe i kemi dorëzuar 12 ekzemplarë, dhe në Ratkoc 12 ekzemplarë.

Me datë: 16.01.2026 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec e falënderon shumë autorin Mustaf Krasniqi për dhurimin e librave të cilët e pasuruan bibliotekën tonë me titullin:

Gjurmët e një meditimi 3 ekzemplarë.

Në djepin e fjalës 3 ekzemplarë.

Me datë 16.01.2025 Udhëheqësja e bibliotekës "Hajdin Berisha" Suharekë Arbrnitë Hoxha Ramaj bashkë me stafin vizituan bibliotekën tonë, gjatë takimit biseduam për bashkëpunime dhe aktivitete.

Me datë: 20.01.2026 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec e falënderon shumë autoren Ilirjana Gashi për dhurimin e librave të cilët e pasuruan bibliotekën tonë me titullin:

100 rrugët e dashurisë 7 ekzemplarë.

Me datë 27.01.2026 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" – Rahovec e falënderon shumë autoren Valbona Hoti për dhurimin e librave të cilët e pasuruan bibliotekën tonë me titullin:

Unë jam forca 8 ekzemplarë.
Vargjet e mia flasin 7 ekzemplarë.

Aktivitete Shkurt

Me datë: 09.02.2026 Në ambientet e Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi", nga shtëpia botuese "Dukagjini" u organizua promovim i lektyrave për fëmijë nga autorë të ndryshëm për nxënësit e klasave të parë deri në klasën e pestë. Në këtë aktivitet u përfshinë rreth njëqind fëmijë të ciklit të ulët shkollor, nën përcjelljen e mësueseve të tyre. Nxënësit u shpërblyen me nga një dhuratë nga organizatori. Shtëpia botuese "Dukagjini" pasuroi edhe bibliotekën tonë me dhjetë (10) ekz.

Me datë: 13.02.2026 Kemi marrë pjesë në shtëpinë e kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec ku u promovua libri i parë me poezi "Brenda botës sime" i autores më të re Ediona Morina, nxënëse e klasës së shtatë në SHFMU "4 Dëshmorët", Ratkoc. Autorja dhuroi pesë (5) ekz. për bibliotekën "Sulejman Krasniqi", Rahovec, urojmë suksese të vazhdueshme në rrugëtimin e saj letrar.

Me datë: 13-17.02.2026 Kemi marrë pjesë në aktivitete për Ditën e Pavarësisë së Kosovës

Aktivitete Mars

Me datë 02.03.2026 Autori Bekim Aliu pasuroi bibliotekën tonë me dy (2) ekzemplërë.

Titulli i librit: Fadil Vokrri legjenda që nuk shuhet kurrë

Me datë: 24.02 deri me 02.03.2026 Në bashkëpunim me Shërbimin Sprovues të Kosovës - Zyra Rajonale në Gjakovë Departamentin për të mitur kemi patur dy të mitur që i është shqiptuar masa e diversitetit për kryerjen e orëve të punës pa pagesë në dobi të përgjithshme. Lloji i punës: Pastrim dhe mirëmbajtje në bibliotekë dhe muze, si dhe punë të tjera që i përshtaten moshës dhe aftësive të miturit.

Me 06.03.2026 Në bibliotekën Komunale Sulejman Krasniqi në Rahovec shënohet 66 vjetori i lindjes së poetit Xhevdet Bajraj, u interpretuan poezi të poetit dhe krijime autorialetë të pranishmeve. Organizimi i orës poetike u bë nga Klubi Letrar Xhevdet Bajraj.

Me këtë rast autori Bedri Zyberaj dhuroi tre (3) libra dhe e pasuroi bibliotekën tonë.

Titulli i librit: Vetëm me vetminë

Me datë 30.03.2026 Autori Ramadan Deli pasuroi bibliotekën tonë me një (1) ekzemplarë.

Titulli i librit: Rahoveci vitet e terrorit serb dhe rezistenca ndaj tij

PALESTRA SPORTIVE "MIZAHIR ISMA"

Gjatë kësaj periudhe Janar-Mars në palestrën sportive "Mizahir Isma" janë realizuar aktivitetet të shumta sportive, ndër aktivitetet janë:

JANAR 2026

KB Rahoveci 029 – KB Ylli (U18) | 10.01.2026 | 10:00
KB Rahoveci 029 – KB Kerasan | 10.01.2026 | 12:00
KB Rahoveci 029 – KB New Basket (U18) | 17.01.2026 | 11:00
KB Rahoveci 029 – Bora | 24.01.2026 | 18:45
SHL Kosova (Volejball) | 25.01.2026 | 17:00
KB Rahoveci 029 – KB Bashkimi | 31.01.2026 | 11:00

SHKURT 2026

KV 17 Korriku – KV Feronikeli | 07.02.2026 | 18:00
KB Rahoveci – Trepça (U14) | 07.02.2026 | 10:00
KB Rahoveci 029 – KB Vllaznimi (U12) | 07.02.2026 | 11:30
KB Rahoveci 029 – KB Vllaznimi | 08.02.2026 | 19:30
Ndeshje për nder të 17 Shkurtit | 13.02.2026, aktivitet sportiv.
Futboll i vogël | 14.02.2026 | 10:00
KH Rahoveci – KH Prishtina | 14.02.2026 | 16:00 & 17:30
KV 17 Korriku – KV Forca | 15.02.2026 | 18:30
KB Rahoveci – Trepça (U18) | 15.02.2026 | 13:30
KH Rahoveci – KH Besa | 19.02.2026 | 18:30 & 20:00
KV 17 Korriku – KV Kaçaniku | 21.02.2026 | 19:30
KB Rahoveci – Junior 06 (U16) | 21.02.2026 | 14:00
KB Rahoveci – KB Bashkimi (U12) | 21.02.2026 | 10:30
KB Rahoveci 029 – KB Prishtina (U14) | 21.02.2026 | 12:30
FC Rahoveci – FC Shtimja | 22.02.2026 | 21:00
KH Rahoveci – KH Trepça | 28.02.2026 | 18:30 & 20:00

MARS 2026

Shoqata Pedagogëve– Futboll i vogël | 03.03.2026 | 11:00
KV 17 Korriku – KV Dukagjini | 05.03.2026 | 20:00
KB Rahoveci – KB Dardania (U12) | 07.03.2026 | 10:00
KB Rahoveci – KB Theranda (U16) | 07.03.2026 | 12:00
FC Rahoveci – FC Jetoni | 08.03.2026 | 21:00
KH Rahoveci – KH Llapi | 08.03.2026 | 15:00 & 17:00
KV 17 Korriku – KV Prishtina | 11.03.2026 | 20:00
Shoqata Pedagogëve - Futboll te vogel | 12.03.2026 | 12:00
KH Rahoveci – KH Vushtrria | 13.03.2026 | 18:30 & 20:00
Shoqata e Pedagogëve – Futboll i vogël | 13.03.2026 | 10:00
KB Rahoveci – KB Pressing (U18) | 14.03.2026 | 12:30
KB Rahoveci 029 – KB Borea (U12) | 14.03.2026 | 11:00

KB Rahoveci 029 –KB Peja | 21.03.2026 | 17:00
FC Rahoveci – FC Komorani | 22.03.2026 | 21:00
KV 17 Korriku – KV Libero | 22.03.2026 | 18:00
Gara shkolla fillore (Volejboll) | 24.03.2026 | 09:00
Gara shkolla të mesme (Volejboll) | 29.03.2026 | 09:30
KB Rahoveci 019 – KB Dardania (U16) | 29.03.2026 | 11:00

PËRFUNDIM

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore janar-mars 2026 është angazhuar në aktivitete dhe punë të ndryshme si:

- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve;
- Vizitë objekteve sportive;
- Takime me klube dhe shoqata sportive;
- Vizitë objekteve kulturore;
- Takim me rini dhe shoqata e organizata rinore;
- Organizimi i aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive;
- Monitorimi i aktiviteteve të subvencionuara nga DKRS-ja;
- Takime të rregullta në kuadër të DKRS-së;
- Përgaditje të raporteve javore, mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore.

Rahovec, prill 2026

Drejtor i DKRS-së
Atdhe Rama

